



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 11.10.2016

Vendim
Nr. 47, datë 11.10.2016

**PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE NË
PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE**

Mbështetur në nenin 3 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 11.10.2016

VENDOSI:

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve të bëhen pranë sekretarisë mësimore të njëjësive kryesore, nga data **10 tetor 2016** deri në datën **20 tetor 2016**.
2. Brenda datës **24 tetor 2016**, njësitë kryesore përkatëse shpallin dhe afishojnë, në vende të dukshme si dhe në faqet e tyre web, listat e aplikantëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve dhe kriteret e miratuara.
3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data **24 tetor 2016** deri në datën **28 tetor 2016**, pranë sekretarisë mësimore përkatëse.
4. Mësimi për programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë fillon më **1 nëntor 2016**.
5. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.